



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

NJESIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “REHABILITIMI URBAN I QENDRES SE FSHATIT
SHEMRI DHE RIKONSTRUKSIONI I HAPSIRAVE EDUKATIVE DHE SPORTIVE TE
SHKOLLES SE MESME TE PERGJITHSHME”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45211360-0, 45212221-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 50,054,911 lekë (Pesedhjetë miliona e pesedhjetë e kater mije e nenteqind e njembedhjetë) , lekë pa TVSH

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78,pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KUKËS ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP(I ndryshuar), dhe nenin 26, neni 30, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas **shtojcës 8 të DST**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP(I ndryshuar), nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(I ndryshuar), si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht 50,054,911 (Pesedhjetë milione e pesedhjetë e katër mijë e nentëqind e njemdhjetë) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.1

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor" (ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28.4.2016) organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar). Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin

e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve **2023-2024-2025** të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivi

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.2.3,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Megjense operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likjuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **25,027,455.5** (njetet e pese milione e njetet e shtate mije e katerqind e pesedhjetë e pese presje pese) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **100,109,822** (njetqind millione e njetqinde e nente mije e teteqind e njetet e dy) leke

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.
- c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- d) Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 39, pika 5 a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar)..*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **vlera limit e kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),neni 39,pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998“*Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit*” (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes , situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vleresimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor,elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbaje kategoritë e mëposhtme:

- 3 N.P-1 A Punime gjurmimi në tokë.
- 4 N.P-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- 5 N.P-7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi dhe vaditje.
- 6 N.P-11 A Ndërtime për nënstatcionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- 7 N.P-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore.
- 8 N.S -1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- 9 N.S-2 A Punime rifiniture të muraturës.
- 10 N.S-6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese.
- 11 N.S-8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri.
- 12 N.S-14 A Impjante te brendeshme,elektrike,telefoni,radiotelefoni TV etj.
- 12 N.S-18 A Punime topogjeodezike.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Liçencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.Vendim Nr. 759, Datë 12.11.2014 Për Licencimin Profesional të Individëve dhe

Subjekteve Juridike që do të Ushtrojnë Veprimtari në Fushën e Studimit e të Projektimit në Ndërtim dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Zbatimit në Ndërtim. Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur në SPE.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik të përfshirë në licencën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt të paktën:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi, profili strukturist	1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknike	1 (një)

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **3(tre) muajt e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit,sic kerkohet në pikën 2.3.3,duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentim: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe

në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.4 Vetdeklarimin nga **inxhinierët e mësipërm** se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohej, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi : Ky kriter është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 77, pika 1, gërma (c) si dhe pika 4 si dhe në mbështetje të nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Është kërkuar nëpërmjet këtij kriteri përcaktimi nga ana e operatorit ekonomik i drejtuesit teknik të punimeve si pjesë e personelit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për realizimin e kontratës pasi drejtuesi teknik i punimeve do të jetë personi përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës referuar pika 2.1 të kreut I të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e

punimeve të ndërtimit” si dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- 1 (një) punonjës të çertifikuar me dëshmi trajnimi si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë
- 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, (i ndryshuar)
- 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm).*

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" 1 (një) punonjës të çertifikuar me dëshmi trajnimi si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” sipas zerave të punimeve që marrin pjesë në realizim të kontratës sipas aktmarreveshjes.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit ,duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohet, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

- Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar për 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së

ofertave. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë....“.

Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sic përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë...“. Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas çertifikimit përkatës shmang dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funkcioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

Sipas nenit 88 PIKA 3) VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shenim: Per kete pike 2.3.5 a) dhe b) te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të

ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit duhet të jetë 40 (dyzet)

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohej, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të të cilave janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Personeli i mësipërm kërkohej në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

40(dyzet) Punonjës te thjeshte prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **3 (tre) muajt e fundit**, të paisur me kontratë pune (te vlefshme), një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” ose të *kontraktuar në rastin kur makineritë janë me qera*, të paktën:

- 1 (nje) Teknik Ndertimi
- 1 (nje) Teknik Topograf
- 1 (nje) Teknik Elektrik
- 1 (nje) Tekanik Mekanik
- 2 (dy) Elektracist
- 1 (nje) Hidraulik
- 2 (dy) Bojaxhi
- 2 (dy) Murator
- 2 (dy) Karpentier
- 2 (dy) Betonues
- 2 (dy) Pllakashtrues
- 2 (dy) Punonjes duralumini
- 1 (nje) Saldator
- 2 (dy) Asfaltoshtrues
- 3 (tre) Shofer
- 2 (dy) Eskavatorist
- 2 (dy) Automakinist
- 2 (dy) Buldozerist

a) Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- diplomë /dëshmi, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- stafi i mesiperm duhet te figuroje ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
- Certificate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT), e cila duhet te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesemarres si dhe subjektet mbeshtetes te deklaruar nga operatoret pjesemarres si *subjekt mbeshtetes*, duhet të deklarojnë per stafin e tyre te dhenat si me poshte:

- Per punonjesin Teknik Ndertimi, Teknik Mekanik dhe Teknik topograf, duhet te deklarohet emer/mbiemer, profili i punes, numer kontrate individuale të punës, diploma perkatese e shkolles se mesme si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin.
 - per punonjesit, Murator, Karpentier, Betonues, Specialist Ndertimi, Asfaltoshtues, Hidraulik, Shofer, numer dhe titull i kualifikimit per diplomën / dëshmi përkatësë, si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin bazuar ne Ligjin 15/2017.
- c) Për punonjesit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste, ofertuesi duhet të paraqesë:
- kontratën individuale të punës te vlefshme;
 - leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.)
(Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- d) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetes te deklaruar nga operatorët pjesemarres si subjekt mbështetes duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj.
- e) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), operatorët ekonomik pjesemarres duhet te deklarojne emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet te plotesoj tabelen me te dhenat si me poshte:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Nr kontrates Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
3				

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.8,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 2 dhe pika 8, si dhe në bazë të nenit 44, pika

1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të plotësojë specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin me cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të materialeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimi CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në specifikimet teknike. Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive duhet të garantohet që mallrat të jenë sipas standarteve europiane. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë materiale të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilësie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, skeda teknike, certifikata cilësie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë sipas kërkesave të projektit.

2.3.9 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues ≥ 15 ton (kapac.mбайtes)	2 cope
2	Mjet transporti vetëshkarkues ≥ 8 ton (kapac.mбайtes)	2 cope
3	Kamionçina (kap mбайtes) deri 3.5 ton	2 copë
4	Fadrome me goma (Skreper)	1 copë
5	Betoniëre	2 copë
6	Vibrator betoni	2 copë
7	Matrapik	2 copë
8	Gjenerator	2 copë
9	Saldatrice	1 copë
10	Skeleri	500 m2
11	Instrument nivelues	1 copë
12	Grejder	1 cope
13	Autobot uji	1 cope

14	Rrul vibrues gome cilinder	1 cope
15	Rrul per ngjeshje asfalti me kapacitet mbi 8 ton	1 cope
16	Frezë asfalti	1 cope
17	Prerëse asfalti	1 cope
18	Autobitumatriçe	1 cope
19	Asfaltoshtruese	1 cope
20	Dumper	1 cope
21	Autovinç	2 cope
22	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	2 cope
23	Autobetoniere	2 cope
24	Eskavator me zinxhir	1 cope
25	Eskavator me goma	1 cope
26	Minieskavator	1 copë
27	Kontenier Stacioner	1 copë
28	Sperkates boje per vizime ne rruge(makineri ose paisje)	1 cope
29	Fabrike per prodhimin e materialeve inerte, te pajisur License nga QKL, Leje Mjedisore kategoria B	pronësi /qira/ kontrate furnizim
30	Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore	pronësi /qira/ kontrate furnizim
31	Impiant per prodhimin e Betonit, te pajisur me leje mjedisore nga QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronesine. Ne rast se impianti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerase.	pronësi /qira/ kontrate furnizim

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 40 copë
- Jelek fosforishent 40 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e. Për mjetet që sipas përcaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi... etj. Operatori ekonomik duhet të deklaroj Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në rubrika përkatëse të dhënat për secilin mjet të kërkuar në shtojcën 8.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në Vendim nr.216 DT 13.04.2023 “Sistemi I Integruar I Manualit Te Cmimeve Ne Nderitim”

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik mjetet dhe pajisjet teknike Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Përcaktimi i makinerive sa me sipër është bërë referuar zërave të punimeve sipas manualit teknik dhe reflektohen në tabelë sa më poshtë:

Tabela e mësipërme është përgatitur në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit.

Për realizimin e punimeve sipas grafikut janë shtuar në listën e makinerive mjetet të cilat cilësohen të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës në kantier vinçi është kërkuar për ngarkim shkarkimin e materialeve që do të përdoren gjatë ndërtimit të objektit.

Gjithashtu janë kërkuar edhe mjete dhe paisje për mbrojtjen personale të punëtorëve, si kokore, kuti të ndihmës së shpejtë etj, si dhe mjete e paisje të sinjalistikës paralajmëruese dhe drejtuese si tabela rrugore , prozhektor për punime natën .

Grafiku i punimeve të jetë sipas të gjithave zërave të punimeve. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- a. Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente.
- b. Certifikatën e menaxhimit të mjedisit /ISO 14001-2026 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 14001-2015 ose ekuivalente.
- c. Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar ISO 45001-2023 ose ekuivalente.
- d. Certifikatën e Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor ISO 39001:2012 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 39001:2012 ose ekuivalente

Pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit 6(gjashte)muaj kalendarikë.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, si dhe në zbatim të

Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

- a) SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/UNI 9001:2015 ose ekuivalente, me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- b) SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001-2026 (e vlefshme) ose ekuivalente, Ky dokument specifikon kërkesat për një sistem menaxhimi mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Ai është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë.
- c) SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose 45001-2023 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001-2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fiuesit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Shenim: Specifikimet/Kriteret teknike jane hartuar nga specialisti perkates i fushes(inxhinieri) ne perputhje me nevojat teknike dhe kerkesat e objektit te prokurimit.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet: “2. Paragrafi i parë, i pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT